

VENDIM
Nr. 130, datë 31.5.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, 10, pika 3, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15 dhe 19, pika 1 germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 830/1 prot., datë 24.5.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘NRG Power’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “NRG Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 673 prot., datë 12.5.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në lidhje me pagesën e aplikimit, shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin e bankës të datës 12.5.2022, me përshkrimin tregtim i energjisë elektrike, por të dhënat e institucionit pritës nuk përkojnë me ato të ERE-s. Gjithashtu, rezulton se kjo shumë nuk është derdhur në llogarinë bankare të ERE-s. Subjektit iu evidentua situata dhe ka bërë me dije se do të bëjë rregullimet përkatëse pranë një banke të nivelit të dytë, për të kaluar këtë shumë në llogarinë e ERE-s. Vlerësojmë që gjatë fazës së fillimit të procedurës t’i jepet mundësia subjektit për të bërë rregullimin përkatës sikurse deklaruar.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a” “b” dhe “c”;
- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa “c”.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për administratorin e saj;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e ndërtimit dhe të funksionimit administrativ të saj.

Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike:

Neni 9, pika 4.8:

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gWh/sipas viteve). Shoqëria duhet të përcaktojë sasinë e energjisë elektrike për t’u tregtuar gjatë 5 viteve të licencës;

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria duhet të përcaktojë shumën që vendos në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti